



→ shprehim të Shtetit  
→ komisioni për Ekonomia  
dhe Financa  
→ shprehim të Komisionit  
Partiake  
përshkrimet  
në Angjellari



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSTITUCIONI I PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS  
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

12.11.18

Nr. Prot. 3194/11

Tiranë, më 9.11 2018

**Lënda:** Dërgohet dekreti i Presidentit të Republikës për propozimin e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

## KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

**TIRANË**

Presidenti i Republikës, në mbështetje të nenit 162 pika 2 të Kushtetutës, si dhe të nenit 19 pika 2, të ligjit nr.154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", me Dekretin nr. 10929, datë 05.11.2018, ka vendosur që Znj.Vitore Tusha t'i propozohet Kuvendit të Shqipërisë për tu zgjedhur në pozicionin Kushtetues të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Presidenti, pas realizimit të një procesi transparent dhe objektiv, ka arritur në konkluzionin se, Doktore e Shkencave Juridike Znj.Vitore Tusha plotëson kushtet dhe kriteret ligjore, si dhe është kandidatura më e përshtatshme për tu zgjedhur në këtë pozicion kushtetues, bazuar në eksperiencën solide dhe kontributin e pandërperë të Znj.Tusha, në fushën e jurisprudencës, si në sistemin gjyqësor, ashtu dhe referuar angazhimeve të saj akademike si pedagoge në institucionet e arsimit të lartë në fushën e së drejtës, trajnuese dhe pedagoge në Shkollën e Magjistraturës, apo edhe si eksperte në fushën e së drejtës kushtetuese e më gjerë.

Gjithashtu duhet sqaruar se Zonjës Vitore Tusha, i ka përfunduar mandati si anëtare e Gjykatës Kushtetuese, që prej datës 10 mars 2017, dhe në përputhje me pikën 3 të nenit 125 të Kushtetutës, ajo nuk mund të riemërohet në këtë pozicion.

Duke mirëpritur shprehjen e interesit prej saj dhe duke zgjedhur një kandidaturë si Znj. Vitore Tusha larg çdo angazhimi partiak në të kaluarën, Presidenti beson se kontribuon për garantimin e pavarësisë së këtij institucioni shumë të rëndësishëm kushtetues.

Sa më sipër, Ju dërgojmë dekretin e Presidentit të Republikës SH.T.Z. Ilir Meta, me nr. 10929, datë 05.11.2018, me anë të të cilit paraqitet propozimi për Kuvendin e Shqipërisë për zgjedhjen e Znj. Vitore Tusha në funksionin kushtetues të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Gjithashtu, bashkëlidhur do të gjeni dosjen me dokumentacionin përkatës të dorëzuar nga Znj. Tusha, administruar pranë Institucionit të Presidentit të Republikës me nr. 3194 prot., datë 30.10.2018, kopje e njehsuar e së cilës është administruar dhe pranë institucionit tonë.

***Ju faleminderit!***

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

ALQI BILAKO